



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**  
**BORDI I AKREDITIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 10, datë 27.01.2023**

**PËR**  
**AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË**  
**“MASTER I SHKENCAVE” NË “PSIKOLOGJI”, ME PROFILE “PSIKOLOGJI**  
**KLINIKE”, “PSIKOLOGJI SHKOLLORE” DHE “PSIKOLOGJI LIGJORE”, TË**  
**UNIVERSITETIT TË NEW YORK-UT NË TIRANË**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2023, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në **“Psikologji”, me profile “Psikologji Klinike”; “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”, me të dhënat si më poshtë:**

- a) Emërtimi i programit: Master i Shkencave në **“Psikologji”, me profile “Psikologji Klinike”; “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”**
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 274, datë 28.08.2020
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti i New York-ut në Tiranë
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Psikologjisë
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite/4 semestra
- g) Kredite (ECTS): 120 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë

- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti i New York-ut në Tiranë
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7
- k) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht

**pasi mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

**konstaton se:**

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush pjesërisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:

1. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në pjesën më të madhe mbulon profilin klinik të tij ndërkohë që mbulesa e profilit ligjor dhe shkollor mbetet e mangët.
2. Përfshirja në të njëjtin program studimi e tre profileve të cilët janë shumë të ndryshëm nga njëri tjetri.
3. Mungesa në planin mësimor të këtij programi studimi e disa komponentëve mësimorë si, orë në auditor, punë e pavarur e studentit, si edhe mungesa e emërimit të lëndëve me zgjedhje që ofrohen sipas profileve përkatëse.
4. Marrëveshjet e nënshkruara nga institucioni, në funksion të realizimit të praktikës profesionale të studentëve të këtij programi studimi, janë të pamjaftueshme dhe jo me impakt në cilësinë e programit të studimit.

*Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,*


## VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji”, me profile “Psikologji Klinike”; “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Ligjore”, të Universitetit të New York-ut në Tiranë.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **3 (tre)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **26.01.2026**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN




Anëtar

TOMASZ JELENSKI




Anëtar

IRAJ HASHI




Anëtar

MAURICE OUDEJANS




Anëtar

LEA YPI




Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ




Anëtar

DARINKA PIQANI




Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

## Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 10, datë 27.01.2023, “Për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “**Psikologji**”, me profile “**Psikologji Klinike**”; “**Psikologji Shkollor**” dhe “**Psikologji Ligjor**”, të **Universitetit të New York-ut në Tiranë**”, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa për mbulimin me personel akademik të kualifikuar dhe në përputhje me formimin e tyre, të profileve Psikologji Shkollor dhe Psikologji Ligjor.
2. Institucioni, të marrë masa për përmirësimin e programit të studimit sa i takon emërtimit dhe tipologjisë së lëndëve, për t'i përafuar me programe të ngjashme studimi të ciklit të dytë në nivel ndërkombëtar, duke u mbështetur në direktivat e *APA* dhe *EuroPsy* dhe për përmirësimin e planit mësimor me tipologji lëndësh sipas profilin të specializimit që ky program studimi synon të zhvillojë.
3. Institucioni, të pasqyrojë në planin mësimor të këtij programi studimi komponentët që lidhen me orët në auditor dhe të studimit individual për lëndën e praktikës profesionale, diplomës, dhe të emërtojë lëndët me zgjedhje që realizohen sipas secilit profil.
4. Institucioni, të rrisë marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e praktikës profesionale të studentëve të këtij programi studimi, me institucione në të cilat roli i psikologut klinik, shkollor dhe ligjor është i konsoliduar.
5. Institucioni, të rrisë përpjekjet për rekrutimin e personelit akademik të kategorisë Profesor, me qëllim hartimin e të gjitha syllabuseve të këtij programi studimi, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
6. Institucioni, të përditësojë syllabuset e këtij programi studimi edhe për profilet Psikologji Shkollor dhe Psikologji Ligjor, duke përfshirë në to njohuri të thelluara sipas tipologjisë së lëndës

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Univeristeti i New York-ut në Tiranë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

